

Udhëzime për përdorim

NWZ-WS613/WS615



Funksionet kryesore të Walkman-it

Dëgjimi i muzikës në Walkman

Kënaquni me muzikë të transferuar në Walkman dhe duke operuar me butonat në Walkman.

Përdorimi i Walkman me telekomandë

Vetëm kyçeni telekomandën dhe mund të përdorni Walkman me telekomandë.

Përdorimi i Walkman me telefon të mençur

Lidhni telefonin tuaj të mençur dhe Walkman me Bluetooth lidhje që të mund të dëgjoni muzikë të ruajtur në telefonin tuaj me Walkman ose përgjigjuni thirrjeve që vijnë në telefon.

Modi miks ju mundëson të dëgjoni zëra nga aplikacionet e telefonit dhe Walkman në kohën e njëjtë.

Mund të përdorni edhe SongPal, një aplikacion i telefonave që ju mundëson të përdorni Walkman duke përdorur telefonin.


Shikoni Help Guide të instaluar në kompjuter ose URL e përmendur në “Mbi manualet” në faqen e parë të këtij manuale për detaje.

Përmbajtja

Ju lutemi kontrolloni pjesët në paketimin.

- Walkman (1)
- Telekomandë (1)
- USB mbajtëse (1)
- Mbulesa për kufje (1 komplet)
- Mbulesa për not (1 komplet)
- Shiriti për përshtatje (1)
- Mbajtëse (1)
- Udhëzime për përdorim (ky manual)
- Përdorim i Walkman-it tuaj gjatë notit

Pjesët dhe kontrollat



Ilustrimet e dhëna janë vetëm për referencë dhe mund të dallojnë nga produkti i vërtetë.

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> 1 Pika prekëse 2 Shtrenguesi për qafë 3 Mbulesa për kufje 4 Seksioni i kufjeve 5 Bluetooth llamba 6 Ⓜ (Bluetooth) butoni 7 VOL (Volume) +*/- butoni
Shtyp VOL + butonin për të rritur dhe VOL – butonin për të ulur zërin. 8 MODE butoni | <ul style="list-style-type: none"> 9 Terminalet 10 ⏪/▶ (Play) butoni *1 11 RESET butoni 12 OPR (Operation) llamba 13 ⏻ (Power) butoni 14 ⏮ Previous) butoni 15 ▶▶ (Next) butoni 16 Bluetooth antena e integruar 17 N-mark 18 Mikrofoni i integruar |
|--|---|

*1 Ka pika prekëse. Përdorni për të ndihmuar me përdorimin e butonave.

Mbi rregullimin e zërit (Vetëm për vendet/rajonet që zbatojnë Direktivat Evropiane dhe Koreane)

Shenja "Kontrolloni nivelin e zërit" shërbejnë për të mbrojtur veshët tuaj gjatë rritjes së nivelit të zërit mbi një nivel të caktuar për herën e parë.

Mund të anuloni alarmin dhe paralajmërimin duke shtypur ndonjë buton.

Shënime

- Mund të rritni nivelin e zërit mi nivelin specifik*1 pas anulimit të alarmit dhe paralajmërimit.
- Pas paralajmërimit fillestar, alarmi dhe paralajmërimet përsëriten çdo 20 orë kumulative që niveli i zërit është vendosur mbi nivelin specifik*1; kur kjo ndodh,
- Nëse zëri është vendosur mbi nivelin specifik* dhe shkyçeni Walkman-in, niveli i zërit kthehet në nivelin specifik* automatikisht.


Si të instaloni mbulesat e kufjeve

Për të dëgjuar cilësi më të mirë të zërit ose për të vendosur në veshë, përdorni madhësinë përkatëse ose rregulloni pozitën e mbulesave për dëgjim të këndshëm në veshin e djathtë dhe të majtë.

Mbulesa rezervë të kufjeve mund të gjeni nga distributori më i afërt Sony.


•Instaloni mbulesat në kufjet që maja e pjesës së brendshme të kufjeve B vendoset mirë në A pozitën në projektimin e kufjeve.

•Siguroni që mbulesat të vendosen drejtë, jo në kënd, për parandaluar mbulesat të dalin dhe të mbesin në veshët tuaj.



A Maja e pjesës së brendshme

Lidhja e Walkman-it tuaj me USB mbajtësen (e dhënë) dhe karikimi i baterisë



1 Thani terminalet e Walkman (1) tuaj duke përdorur një leckë të thatë nëse duhet.

2 Lidhni Walkman me USB mbajtësin në rend të anës së majtë (L) njëherë dhe pastaj të djathtë (R).

Siguroni që terminalet e Walkman (1) dhe USB mbajtësit (2) janë në kontakt me njëri-tjetrin.

3 Lidhni Walkman tuaj me kompjuter të kyçur duke përdorur USB mbajtësin.

Duhen rreth 1.5 orë për të karrikuar tërësisht baterinë.

Shënim

- Për të parandaluar prishjen e baterisë, karrikoni baterinë njëherë në çdo gjashtë muaj ose një herë në vit.

⚠ Këshillë

- Telekomanda nuk mund të karrikohet sepse bateri në formë monedhe litiumi përdoret. Nëse bateria është tepër e ulët, ndryshoni baterinë e telekomandës. Për detaje si të ndryshoni baterinë e telekomandës, shikoni Help Guide të instaluar në kompjuterin tuaj ose URL e përmendur në “Mbi manualet” në faqen e parë të këtij manuali.

Si të instaloni dhe lexoni Help Guide

Instaloni “Help Guide” në kompjuterin tuaj. Aty gjenden përdorimet e thjeshta të Walkman, ueb faqja për mbështetje të konsumatorit dhe si të transferoni përmbajtje si muzikë në Walkman.

1 Lidhni Walkman-in ruaj me kompjuter të kyçur.

2 Hapni dosjet më poshtë dhe klikoni dy herë në skedarin ekzekutiv në Walkman.

- Windows 7 ose më të vjetër: [Start] – [Computer] – [WALKMAN] – [FOR_WINDOWS] – [Help_Guide_Installer(.exe)].
- Windows 8: [Start screen] – [Desktop] – [File Explorer] – [Computer] – [WALKMAN] – [FOR_WINDOWS] – [Help_Guide_Installer(.exe)].
- Windows 8.1: [Desktop] – [File Explorer] – [This PC] – [WALKMAN] – [FOR_WINDOWS] – [Help_Guide_Installer(.exe)].
- Mac: [Finder] – [WALKMAN] – [FOR_MAC] – [Help_Guide_

3 Ndiqni udhëzimet në ekran për të kompletuar instalimin.


4 Për të lexuar Help Guide, klikoni dy herë në ikonën ose shkurtesën që është krijuar në kompjuterin tuaj.



* 4 5 3 6 9 0 5 1 3 * (1)

Si të mbani Walkman-in në veshë


1 Kontrolloni anët e majtë (L) dhe të djathtë (R) të Walkman.




2 Vareni shtrënguesin për qafë në majë të veshëve dhe pas kokës.

3 Vendosni Walkman-in tuaj në veshë.



4 Përshtatani Walkman-in tuaj për dëgjim të këndshëm.



Dëgjimi i muzikës




1 Lidhni Walkman tuaj me kompjuter të kyçur me USB mbajtësin dhe transferoni muzikë në Walkman.


2 Shtyp dhe mbaj  butonin që gjendet në të djathtë () për 3 sekonda për të kyçur Walkman. OPR llamba ndryshon në gjelbër pas ndriçimit në ngjyrë portokalli.

3 Shtyp  butonin që gjende në të djathtë (R).

🔧 Këshillë


- Për udhëzime të hollësishme mbi transferimi ne muzikës në Walkman dhe dëgjimi i muzikës së ruajtur në telefon, shikoni Help Guide.
- Për të shkyçur Walkman, shtyp dhe mbaj  butonin për 3 sekonda.

Përdorimi i telekomandës (e dhënë)



1 Kyçeni Walkman.

2 Kyçeni telekomandën.


Telekomanda kyçet duke shtypur dhe mbajtur butonin  për 2 sekonda dhe llamba fillon të ndriçojë. Kur telekomanda të lidhet me Walkman, llamba shkyçet.

3 Shtyp butonin e duhur për të përdorur Walkman.


Çiftimi dhe lidhja me telefonin tuaj


Çiftimi mund të fillohet vetëm kur Bluetooth modi i Walkman është shkyçur.

1 Vendos Walkman në modin e çiftimit.

Shtyp dhe mbaj  butonin që gjendet në të majtë (L) për 7 sekonda.

Bluetooth llamba që gjendet në majtë (L) ndriçon në ngjyrë blu shpejtë dhe përsëritur.

Kur të lidhni Walkman dhe telefonin tuaj për herën e dytë dhe tutje, shtypni dhe mbani  butonin për 2 sekonda.



2 Në telefonin tuaj, kyçni Bluetooth funksionin dhe gjeni Walkman në ekranin e Bluetooth aparatit.

Ndiqni udhëzimet në ekran për të kompletuar rregullimet.

Kur të paraqitet listë e pajisjeve, zgjidhni [NWZ-WS613] ose [NWZ-WS615].

Nëse kërkohet fjalëkalim, shënoni “0000.”

Walkman juaj dhe telefoni janë të regjistruar me njëri tjetrin dhe lidhja do të vendoset.

🔧 Këshillë

- Mund të çiftoni Walkman dhe telefonin tuaj me anë të (NFC) funksionit. Shikoni Help Guide të instaluar në kompjuterin tuaj ose URL e përmendur në “Mbi manualin” në faqen e parë të këtij manuali.


Mënjanimi i problemeve

Nëse Walkman-i juaj nuk funksionon mirë, provoni hapat më poshtë për të zgjedhur çështjen.

1 Gjeni simptomat e çështjes në "Mënjanimin e problemeve" në Help Guide (HTML dokument) dhe provoni ndonjërin prej veprimeve më poshtë.

2 Lidhni Walkman me kompjuter për të karrikuar baterinë.

3 Shtypni RESET butonin me laps ose me kapëse për letra, etj.



Simptoma/Zgjidhja

Kompjuteri juaj nuk e njeh Walkman-in tuaj.

Vendosni Walkman-in tuaj në USB mbajtësen mirë dhe fort. Karrikimi do të fillojë (OPR llamba ndriçon kuq)madje edhe nëse lidhja nuk është bërë mirë, por ka mundësi që kompjuteri mos të ketë njohur Walkman-in. Në këtë rast, largoni Walkman-in nga USB mbajtësi dhe pastaj lidhni sërish USB mbajtësin.

- Bateria e mbetur është tepër e ulët ose e pamjaftueshme.
- Kur të përdorni Walkman-in tuaj për herën e parë ose nuk e keni përdorur për një kohë të gjatë, mund të kalojë disa minuta për të njohur nga kompjuteri, edhe nëse karrikimi vetëm më ka filluar (OPR llamba ndriçon ngjyrë portokalli). Kontrolloni që kompjuteri njeh Walkman-in pasi që të lidhni për kompjuteri për rreth 5 minuta.

Nuk mund të regjistroi (çiftoni) Bluetooth pajisje.

- Nëse profilet e mbështetjes janë të ndryshëm, Walkman dhe pajisja Bluetooth nuk mund të çiftohen. Për më tepër, shikoni pjesën “Specifikimet” në Help Guide.

Simptoma/Zgjidhja

Nuk mund të lidheni me Bluetooth funksionin.

- Kontrolloni që Bluetooth funksioni është aktivizuar në telefon dhe Walkman.
- Kontrolloni që emri i modelit të Walkman shfaqet si i lidhur më [Settings] - [Bluetooth] ekranin e telefonit. Nëse Walkman nuk është lidhur, prekeni emrin e modelit.

Nuk mund të përdorni Walkman me telekomandën (e dhënë)

- Siguroni që telekomanda është kyçur.
- Siguroni që Walkman është kyçur.
- Ri-nisni telekomandën dhe Walkman. Për më tepër informacione, shikoni “Nuk mund të përdorni Walkman me telekomandë në Help Guide.
- Nuk mund të përdorni telekomandën kur është lagur. Thajeni telekomandën duke përdorur një leckë të thatë.
- Ndryshoni bateritë ne telekomandë. Për më tepër informacione, shikoni pjesën “Ndryshimi i baterive të telekomandës” në Help Guide.

Paralajmërim

Për dëgjuet brenda veshit

Mbulesat e kufjeve mbulojnë veshët tuaj. Andaj, keni kujdes që ka rrezik të dëmtimit të veshëve ose tapanit të veshit nga shtypja e madhe nga mbulesat ose mbulesat mund të largohen nga veshët. Pas përdorimit, kujdes që të largoni mbulesat me lehtësi dhe ngadalë.

Për kufjet

- Mos lëshoni njësinë në zë të lartë sepse dëgjimi më afatgjatë me zë të lartë mund të ndikojë mbi të dëgjuarit
- Në zë të lartë, zërat e jashtme mund mos të dëgjojen. Mos dëgjoni me njësinë në situata ku dëgjimi nuk duhet të pengohet, për shembull gjatë vozitjes ose drejtimit të biçikletës.
- Meqë kufjet e dhëna janë të dizajnit të hapur, zëri kalon nëpër kufjet. Mbani mend që mos të pengoni personave që janë afër juve.

Nëse vaj rrezitje hyn në Walkman ose telekomandë, lajeni duke përdorur ujë të vakët. Ndryshe, mund të shkaktohet humbje e ngjyrës ose dëmtim si të çara mund të paraqiten.

Shënim i pronarit

Modeli dhe numrat serik gjenden mbrapa aparatit. Shënoni në vendin e dhënë më poshtë. Shikoni këto numra çdoherë kur të lajmëroni Sony distributorin në lidhje me produktin. Nr. i modelit. _____

Nr. seri. _____

TRA

REGISTERED No: ER34837/14

DEALER No: DA0096946/12

Shënim mbi licencat dhe markat tregtare

- Për informacione mbi ligjet, rregullat dhe markat tregtare, shikoni “Informacione të rëndësishme” që gjenden në softuerin e dhënë. Për të mundur të lexoni, instaloni softuerin në kompjuter.
- Apple, Apple logo, iPhone, iPod, iPod touch, iTunes, Mac, iOS dhe OS X janë marka të Apple Inc., të regjistruar në SHBA dhe vende tjera. App Store është markë servisi e Apple Inc.
- “Made for iPod,” dhe “Made for iPhone,” nënkupton që aksesoret elektronik janë dizajnuar për të lidhur vetëm me iPod, ose iPhone, në fakt është certifikuar nga zhvilluesi për të plotësuar standardet e performancës së Apple. Apple nuk është përgjegjëse për funksionimin e këtij aparati ose përputhjes me standardet dhe rregullat e sigurisë. Ju lutemi të keni parasysh që përdorimi me iPod, ose iPhone mund të ndikojë mbi performancën pa tel.

iPhone/iPod modele kompatible

Bluetooth teknologjia punon me iPhone 5s, iPhone 5c, iPhone 5, iPhone 4s, iPhone 4, iPhone 3GS, dhe iPod touch (gjenerata e 4 dhe 5).



Dizajni dhe specifikimet mund të ndryshohen pa paralajmërim paraprak.